FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 53

Tiranë – E enjte, 18 prill 2019

PËRMBAJTJA

		Faqe
Dekret i Presidentit nr. 11167, datë 10.4.2019	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	4085
Dekret i Presidentit nr. 11172, datë 12.4.2019	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	4085
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 199, datë 10.4.2019	Për përcaktimin e kryetarit dhe emërimin e anëtarëve, përfaqësues të pushtetit qendror, në Këshillin Drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit.....	4086
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 200, datë 10.4.2019	Për një shtesë në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit", të ndryshuar.....	4086
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 202, datë 10.4.2019	Për përcaktimin e tarifave për lëshimin e dokumenteve ligjore për transferimin ndërkombëtar të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë, që lëshohen nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve.....	4087
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 203, datë 10.4.2019	Për përcaktimin e kritereve, të masës së përfitimit dhe llojeve të pushimeve të tjera, me apo pa pagesë, në shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.....	4088
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 204, datë 10.4.2019	Për miratimin e buxhetit për Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale, për vitin 2019.....	4090
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 205, datë 10.4.2019	Për miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit "tokë bujqësore" (arë) në "tokë urbane" (truall), të pasurisë me nr. 1/27, zona kadastrale 3339, Bashkia Durrës, për ndërtimin e një kapanoni njëkatësh, fabrikë prodhimi të bojërave, nga ana e "ZEUS-al" sh.p.k.....	4091
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 206, datë 10.4.2019	Për pjesëmarrjen e Shqipërisë në panairin ndërkombëtar "EXPO 2020 Dubai".....	4091

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 207, datë 10.4.2019	Për përcaktimin e autoriteteve kompetente dhe të procedurës që do të ndiqet për përmbushjen e detyrimeve të caktuara nga gjykata për të miturin në konflikt me ligjin.....	4092
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 208, datë 10.4.2019	Për përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale.	4097
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 209, datë 10.4.2019	Për përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale.....	4101
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 240, datë 4.4.2019	Për miratimin e kritereve për ndarjen e kompensimit financiar të operatorëve me eksperiencë në transmetimet numerike dhe operatorëve privatë historikë kombëtarë.....	4103
Udhëzim i ministrit të Mbrojtjes nr. 3, datë 3.4.2019	Për informimin e Ministrisë së Mbrojtjes nga strukturat dhe sh.a.-të në vartësi të saj mbi zhvillimin e ankandeve dhe lidhjen e kontratave në zbatim të procedurave të ankandeve, prokurimeve dhe marrëveshjeve të tjera.....	4104
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 6, datë 2.4.2019	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 1, datë 9.1.2019, "Për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë, viti shkollor 2018–2019".....	4105
Urdhër i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 128, datë 11.4.2019	Për delegimin e kompetencave.....	4106
Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 6660, datë 5.4.2019	Me objekt: fillimin e procedurës së falimentit për pasuritë e shoqërisë "ITSGA" sh.a., për shkak të paaftësisë paguese.....	4106

DEKRET
Nr. 11167, datë 10.4.2019

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c", dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Bajram Shefki Krasniqi
2. Shqipe Avdyl Krasniqi
3. Betim Avdyl Krasniqi
4. Kushtrim Avdyl Krasniqi
5. Lulëkuqe Abdyl Krasniqi
6. Merita Jetulla Daci (Mjekiqi/Mjeku)
7. Majlinda Nexhat Daci Ajvazi (Daci)
8. Hysen Ramadan Ajvazi
9. Bonart Hysen Ajvazi
10. Agnesë Hysen Ajvazi
11. Edi Nexhat Daci Prapashtica (Daci)
12. Ilir Jusuf Prapashtica
13. Ylli Ilir Prapashtica
14. Vesa Ilir Prapashtica
15. Burim Haki Baraku
16. Besnik Burim Baraku
17. Nora Driton Baraku (Pllana)
18. Bleron Burim Baraku
19. Ramon Acesor Maximo Lusterio
20. Nifa Braim Ademaj (Dinaj)
21. Albena Refki Reshitaj
22. Violeta Daut Veseli (Jupolli)
23. Gafurr Ehadin Plakolli
24. Fatmir Milaim Daku
25. Vincenzo Giuseppe Foca'
26. Besim Mehmet Kajtazi (Kajtazaj)
27. Sadete Zymer Demaj Kajtazi (Demaj)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

DEKRET
Nr. 11172, datë 12.4.2019

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Ledina Elmas Çelo-Kabashi (Çelo)
2. Iris Jorgaq Heimbuch (Maliqi)
3. Keira Melody-Sol Elvis Heimbuch
4. Serxhio Javer Koçiu
5. Muhamet Faik Shahinaj
6. Besmira Shaban Nikshiqi
7. Julinda Lavdosh Roshi (Limaj)
8. Afrim Esat Baraku
9. Lejdi Astrit Dikollari
10. Teuta Gori Stefi
11. Edlira Fatmir Lybeshari (Shkurti)
12. Vladimir (Valmir) Arso Matanoviq (Dimnaku)
13. Afërdita (Aferdita) Sali Hasandoçi (Nezaj/Hasandoçaj/Hasandoci)
14. Elvis Fatmir Duro
15. Anton Rakip Doçi
16. Majlinda Cen Saliaj (Zenelaj/Uka)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 199, datë 10.4.2019

PËR PËRCAKTIMIN E KRYETARIT DHE EMËRIMIN E ANËTARËVE, PËRFAQËSUES TË PUSHTETIT QENDROR, NË KËSHILLIN DREJTUES TË FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10, të ligjit nr. 10130, datë 11.5.2009, "Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e zëvendëskryeministrit, z. Erion Braçe, kryetar të këshillit drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit.
2. Emërimin e anëtarëve, përfaqësues të pushtetit qendror, në këshillin drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, si më poshtë vijon:
- znj. Elva Margariti, ministër i Kulturës;
- znj. Belinda Ikonomi, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë;
- znj. Ornela Çuçi, zëvendësministër i Turizmit dhe Mjedisit;
- z. Artan Shkreli, zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë.
3. Vendimi nr. 982, datë 25.10.2013, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kryetarit dhe emërimin e anëtarëve, përfaqësues të pushtetit qendror, në këshillin drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit", i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 200, datë 10.4.2019

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, dhe 28, pika 1, të ligjit nr.157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", me propozimin e Kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (lista e OKB-së), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit", të ndryshuar, të bëhet shtesa, si më poshtë vijon:

Në listën e shkronjës "C", të titulluar "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da'esh) dhe AL-Qaida", shtohet individi i renditur në shkronjën "a", sipas shtesës bashkëlidhur këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për persona që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatave ISIL (Da'esh) dhe AL-Qaida".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

PËRDITËSIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT TË OKB-së (LISTA E OKB-së)

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATAT ISIL (DA'ESH) DHE AL-QAIDA":

a) Lista e shtuar në "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (Da'esh) dhe AL-Qaida":

1: TARIQ GIDAR GROUP (TGG)

Shënim. Gjenealitetet e tjera për personin, emri i të cilit është renditur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

VENDIM
Nr. 202, datë 10.4.2019

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR LËSHIMIN E DOKUMENTEVE LIGJORE PËR TRANSFERIMIN NDËRKOMBËTAR TË MALLRAVE USHTARAKE DHE TË ARTIKUJVE E TEKNOLOGJIVE ME PËRDORIM TË DYFISHTË, QË LËSHOHEN NGA AUTORITETI I KONTROLLIT SHTETËROR TË EKSPORTEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 46, të ligjit nr. 46/2018, "Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e tarifave për lëshimin e dokumenteve ligjore për transferimin ndërkombëtar të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë, që lëshohen nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Vendimi nr. 341, datë 8.4.2009, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e tarifave për lëshimin e dokumenteve ligjore nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve subjekteve të përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë", shfuqizohet.

3. Ngarkohet Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Lidhja nr.1
Tarifat për lëshimin e dokumenteve ligjore për transferimin ndërkombëtar të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë

SHËRBIMI	TARIFA NË LEKË
1. Licencë individuale eksporti për mallra ushtarake	3 000
2. Licencë individuale për eksport të përkohshëm për mallrat ushtarake	3 000
3. Licencë individuale për rieksport për mallra ushtarake	3 000
4. Licencë individuale importi për mallra ushtarake	3 000
5. Licencë individuale për import të përkohshëm për mallrat ushtarake	3 000
6. Licencë individuale për transit ndërkombëtar të mallrave ushtarake	3 000
7. Licencë individuale për *transship* ndërkombëtar të mallrave ushtarake	3 000
8. Licencë individuale për veprimtari ndërmjetësuese (*brokerage*) për mallrat ushtarake	3 000
9. Autorizim për negocim të marrëveshjeve ndërkombëtare për mallra ushtarake për vendet nën embargo	3 000
10. Certifikatë e regjistrimit për mallrat ushtarake	3 000
11. Certifikatë ndërkombëtare importi për mallra ushtarake	3 000
12. Certifikatë e përdoruesit të fundit për mallra ushtarake	3 000

13. Certifikatë e mbërritjes së mallit në destinacion (DVC) për mallra ushtarake	3 000
14. Licencë individuale eksporti për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë	3 000
15. Licencë globale eksporti për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë	3 000
16. Licencë individuale për eksport të përkohshëm për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë	3 000
17. Licencë individuale për rieksport për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë	3 000
18. Licencë individuale importi për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë	3 000
19. Licencë globale importi për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë	3 000
20. Licencë individuale për import të përkohshëm për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë	3 000
21. Licencë individuale për veprimtari ndërmjetësuese (*brokerage*) për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë	3 000
22. Licencë individuale për transferim *software* ose të teknologjive nëpërmjet rrugëve elektronike	3 000
23. Licencë individuale për transit ndërkombëtar të artikujve dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë	3 000
24. Licencë individuale për *transship* ndërkombëtar të artikujve dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë	3 000
25. Licencë individuale për mallrat që nuk përfshihen në listën e miratuar për kontroll	3 000
26. Autorizim për negocim të marrëveshjeve ndërkombëtare për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë	3 000
27. Certifikatë ndërkombëtare importi për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë	3 000
28. Certifikatë e përdoruesit të fundit për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë	3 000
29. Certifikatë e mbërritjes së mallit në destinacion (DVC) për artikujt dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë	3 000
30. Lëshim dublikate i licencës/ certifikatës/ autorizimit të dhënë	1 000

VENDIM
Nr. 203, datë 10.4.2019

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË MASËS SË PËRFITIMIT DHE LLOJEVE TË PUSHIMEVE TË TJERA, ME APO PA PAGESË, NË SHËRBIMIN E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 30, të ligjit nr. 152/2015, "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. KOHËZGJATJA E PUNËS/SHËRBIMIT

1. Koha normale e punës/shërbimit për punonjësin e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin me gradë (në vijim shërbimi i MZSH-së) është 40 orë në javë.

2. Për efekt të llogaritjes së pagës orare, muaji konsiderohet, mesatarisht, me 174 orë pune.

3. Shërbimi i gatishmërisë për punonjësin operacional të shërbimit të MZSH-së, si rregull, organizohet sipas një planifikimi mujor, me turne 24-orëshe ose 12-orëshe, pa ndërprerje.

4. Punonjësi me gradë i shërbimit të MZSH-së, për orët shtesë të punës/shërbimit, që nuk janë kompensuar me pushim, përfiton një shtesë mbi pagë në masën:

a) 25 % për çdo orë pune/shërbimi shtesë në ditë të zakonshme pune;

b) 50 % për çdo orë pune/shërbimi shtesë të kryer gjatë pushimit javor;

c) 25% për çdo orë pune në ditët e festave zyrtare;

ç) 50% për çdo orë pune në ndërhyrje operacionale të kryer nga ora 22:00 deri në orën 06:00.

5. Për nevoja pune/shërbimi, me urdhër të titullarit të strukturës vendore të shërbimit të MZSH-së, pas kërkesës së drejtuesit të strukturës përkatëse, punonjësit të shërbimit të MZSH-së mund t'i ndërpritet koha e pushimit ditor/vjetor, duke urdhëruar zgjatjen e kohës së punës/shërbimit.

6. Në rrethana të jashtëzakonshme, titullari i strukturës përkatëse mund të urdhërojë zgjatjen e kohës së punës/shërbimit, pas konfirmimit nga kryetari i bashkisë.

7. Urdhri për zgjatjen e kohës së punës/shërbimit mbi kohën normale, sipas përcaktimit të pikës 5, të këtij kreu, përcakton:

a) arsyen e zgjatjes së orëve të punës/shërbimit;

b) kohën e fillimit dhe të përfundimit;

c) numrin e punonjësve;

ç) koston financiare.

8. Paga për orët jashtë orarit, që i shtohet pagës mujore, paguhet vetëm kur është parashikuar për këtë qëllim, brenda 3 muajve, nga dita kur është kryer shërbimi.

9. Procedurat standarde për mënyrën e pagesës së orëve shtesë të punës/shërbimit mbi kohën normale të punës të punonjësve të shërbimit vendorë të MZSH-së miratohen me urdhër të kryetarit të bashkisë.

II. PUSHIMET VJETORE

1. Punonjësi me gradë i shërbimit të MZSH-së gëzon të drejtën e pushimeve vjetore të paguara, si më poshtë vijon:

a) 40 ditë kalendarike për punonjësit me gradë "Drejtues i parë zjarrfikës", "Drejtues i lartë zjarrfikës";

b) 35 ditë kalendarike për punonjësit me gradën "Drejtues zjarrfikës", "Komisar zjarrfikës";

c) 30 ditë kalendarike për punonjësit me gradën "Kryeinspektor Zjarrfikës", "Inspektor zjarrfikës";

ç) 28 ditë kalendarike për punonjësit me gradë "Kryezjarrfikës", "Zjarrfikës", "Asistent Zjarrfikës".

2. Planifikimi dhe koha e kryerjes së pushimeve vjetore miratohet nga ministri përgjegjës, për punonjësit e drejtorisë së shërbimit të MZSH-së pranë kësaj ministrie, dhe nga kryetari i bashkisë përkatëse, për punonjësit e shërbimit vendor të MZSH-së, pas konsultimit me punonjësin, pa cenuar vijueshmërinë e punës, brenda muajit shkurt të çdo viti.

3. Punonjësi i shërbimit të MZSH-së ka të drejtë të kërkojë kryerjen e pushimit vjetor në periudha të ndryshme e të ndara, në përputhje me pikën 1, të këtij kreu.

4. Gjatë kryerjes së pushimeve vjetore punonjësi trajtohet financiarisht në të njëjtën masë me pagën që ai merr kur është në punë/shërbim.

5. Kur, për arsye pune apo shërbimi, pushimi vjetor nuk mund të jepet brenda vitit, ai duhet të jepet jo më vonë se në muajin mars të vitit pasardhës.

6. Shkëputja e marrëdhënieve financiare për punonjësin, i cili ndërpret marrëdhëniet e punës me strukturat e shërbimit të MZSH-së, bëhet pas përfundimit të pushimeve vjetore të kryera.

7. Kur punonjësi nuk ka kryer një vit të plotë kalendarik pune, kohëzgjatja e pushimit vjetor të paguar përcaktohet në përpjesëtim të drejtë me kohëzgjatjen e marrëdhënieve të punës së kryer brenda vitit kalendarik.

III. LEJET E PAGUESHME DHE PA TË DREJTË PAGE

1. Punonjësit të shërbimit të MZSH-së i jepet leje e pagueshme për rastet, si më poshtë vijon:

a) martesën e tij: 5 ditë;

b) martesën e fëmijës:3 ditë;

c) lindjen e fëmijës, për baballarët: 3 ditë;

ç) vdekjen e familjarëve të afërt: 5 ditë;

d) ndërrimin e banesës: 2 ditë;

dh) sëmundje të rënda të fëmijëve, prindërve: 5 ditë;

2. Punonjësit e MZSH-së, për arsye personale apo familjare, gëzojnë të drejtën e lejes pa të drejtë page për një periudhë deri në 30 ditë.

3. Lejet pa të drejtë page për një periudhë deri në 30 ditë jepen nga ministri përgjegjës, për punonjësit e drejtorisë së MZSH-së pranë Ministrisë së Brendshme, dhe nga kryetari i bashkisë përkatëse, për punonjësit e strukturave vendore, sipas kërkesës së argumentuar nga punonjësi dhe të miratuar nga drejtuesi i strukturës.

4. Leje pa të drejtë page, për një periudhë më të gjatë se 2 muaj, jepet vetëm për studime dhe kualifikime (brenda ose jashtë shtetit) për punonjësit e nivelit të mesëm dhe të lartë të shërbimit të MZSH-së. Kjo leje nuk mund të zgjasë më shumë se 1 vit dhe jepet nga drejtori i përgjithshëm i shërbimit të MZSH-së, për punonjësit e strukturave vendore, me propozimin e kryetarit të bashkisë, dhe nga ministri përgjegjës, për punonjësit e drejtorisë së MZSH-së pranë ministrisë përgjegjëse, me propozimin e drejtuesit të kësaj strukture.

5. Periudha e lejes pa të drejtë page nuk llogaritet në vjetërsi pune të shërbimit dhe as për efekt të ecurisë në karrierë. Pas përfundimit të saj punonjësi i MZSH-së kthehet në të njëjtën detyrë.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Pushimet vjetore, lejet e pagueshme, lejet pa të drejtë page, si dhe koha e kryerjes së tyre shënohen në dosjen e personelit të punonjësit.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkitë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 204, datë 10.4.2019

PËR MIRATIMIN E BUXHETIT PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE, PËR VITIN 2019

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 189/c, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, "Për pronësinë industriale", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e buxhetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, për vitin 2019, sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Tabela nr. 1

PLANI TË ARDHURA – SHPENZIME PËR VITIN 2019

000/LEKË

Të ardhurat		**Shpenzimet**	
Të ardhura nga aktiviteti kryesor	120 000	Shpenzime personeli	44 000
Të trashëguara investime dhe projekte në vazhdim	55 277	Shpenzime operative dhe korrente	10 068
Marrëveshja e Madridit	67 588	Transferta korrente e jashtme	20 000
Marrëveshja e Hagës	1 075	Shpenzime kapitale	76 705
Të ardhura nga marrëveshja e shtrirjes me ZEP-in	250	Totali i shpenzimeve	150 773
		Teprica derdhje në buxhetin e shtetit	93 417
Totali i të ardhurave	**244 190**	**Totali i shpenzimeve dhe teprica në buxhetin e shtetit**	**244 190**

VENDIM
Nr. 205, datë 10.4.2019

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT, NGA KATEGORIA E RESURSIT "TOKË BUJQËSORE" (ARË) NË "TOKË URBANE" (TRUALL), TË PASURISË ME NR. 1/27, ZONA KADASTRALE 3339, BASHKIA DURRËS, PËR NDËRTIMIN E NJË KAPANONI NJËKATËSH, FABRIKË PRODHIMI TË BOJËRAVE, NGA ANA E "ZEUS-AL" SHPK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "a", të pikës 3, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit "tokë bujqësore" (arë) në "tokë urbane" (truall), të pasurisë me nr. 1/27, zona kadastrale 3339, Bashkia Durrës, me sipërfaqe prej 4 870 (katërmijë e tetëqind e shtatëdhjetë) m², sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi, për ndërtimin e një kapanoni njëkatësh, fabrikë prodhimi të bojërave, nga ana e "ZEUS-AL" sh.p.k.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës të qarkut Durrës të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral përkatës ndryshimet e kategorisë së resursit, nga "tokë bujqësore" (arë) në "tokë urbane" (truall), për sipërfaqen prej 4 870 (katërmijë e tetëqind e shtatëdhjetë) m², sipas pikës 1, të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës të qarkut Durrës, Këshilli i Qarkut Durrës, Agjencia Shtetërore e Kadastrës (Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës) dhe Bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Lidhja nr. 1

Tokë arë (kategoria V)

Bashkia	Njësia administrative	Fshati	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Pronari	Lloji i pasurisë	Kategoria e tokës bujqësore	Truall i kërkuar (m²)
Durrës	Rrashbull	Vrrinë	3339	1/27	Shoqëria "ZEUS-AL" sh.p.k.	arë	V	4 870
TOTALI								**4 870**

VENDIM
Nr. 206, datë 10.4.2019

PËR PJESËMARRJEN E SHQIPËRISË NË PANAIRIN NDËRKOMBËTAR "EXPO 2020 DUBAI"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pjesëmarrjen e Shqipërisë në Panairin Ndërkombëtar "EXPO 2020 DUBAI".

2. Shqipëria të përfaqësohet nga Komisari i Përgjithshëm i Shqipërisë, i cili nënshkruan kontratën e pjesëmarrjes në Panairin Ndërkombëtar "EXPO 2020 DUBAI", i udhëhequr nga tema kryesore e panairit "Bashkojmë idetë, krijojmë të ardhmen".

3. Ngritjen e grupit të punës për organizimin dhe pjesëmarrjen e Shqipërisë në Panairin Ndërkombëtar "EXPO 2020 DUBAI", i cili do të kryesohet nga drejtori i Agjencisë Shqiptare të

Zhvillimit të Investimeve (AIDA) dhe ka në përbërje anëtarë, përfaqësues nga:

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Ministria e Kulturës;
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit.

4. Objekti i veprimtarisë së grupit të punës të jetë si më poshtë vijon:

- përcaktimi i tematikës së pavijonit të Shqipërisë;
- përzgjedhja e Ditës Kombëtare të Shqipërisë;
- përcaktimi i kalendarit të aktiviteteve sipas çdo institucioni;
- përcaktimi i listës së pjesëmarrësve sipas kalendarit të aktiviteteve;
- përllogaritja e kostove administrative për pjesëmarrjen e çdo institucioni në panair.

5. Autorizohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) për menaxhimin dhe administrimin e pavijonit shqiptar në Panairin Ndërkombëtar "EXPO 2020 DUBAI", si dhe të veprimeve financiare nën mbikëqyrjen e grupit të punës, kryesuar nga Komisari i Përgjithshëm i Shqipërisë.

6. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Kulturës, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) dhe Komisari i Përgjithshëm i Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 207, datë 10.4.2019

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETEVE KOMPETENTE DHE TË PROCEDURËS QË DO TË NDIQET PËR PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE TË CAKTUARA NGA GJYKATA PËR TË MITURIN NË KONFLIKT ME LIGJIN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 102, të ligjit nr. 37/2017, "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur", me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

I. Rregulla të përgjithshme

1. Ky vendim përcakton autoritetet kompetente dhe procedurën që ndiqet prej tyre në rastet kur gjykata urdhëron të miturin në konflikt me ligjin të përmbushë një nga detyrimet e caktuara në përputhje me nenin 102, të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

2. Qëllimi i përmbushjes së detyrimeve të caktuara në pikën 1, të këtij kreu, është rishoqërizimi, riintegrimi, rehabilitimi dhe parandalimi i rikryerjes së veprës penale ose e kryerjes së një vepre tjetër penale, duke i ofruar të miturit kujdes, asistencë dhe mbikëqyrje.

3. Autoritetet e caktuara në këtë vendim dhe procedura që do të ndiqet prej tyre janë të njëjta, pavarësisht nëse përmbushja e detyrimeve të caktuara jepet si dënim plotësues ose si dënim jo me burgim.

II. Autoritetet kompetente

1. Autoritet kompetent është organi ose institucioni shtetëror, strukturat në nivel qendror dhe vendor, që brenda fushës së veprimtarisë, sipas vendimit të gjykatës, ndjek/in përmbushjen e detyrimeve të caktuara ndaj të miturit në konflikt me ligjin.

2. Autoriteti kompetent caktohet nga gjykata, në varësi të natyrës së detyrimit që duhet të përmbushë i mituri në konflikt me ligjin.

3. Autoritetet qendrore, përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi, janë:

a) Ministria e Drejtësisë;

b) ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit;

c) ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit, arsimit dhe formimit profesional;

ç) ministria përgjegjëse për çështjet e shëndetit dhe mbrojtjes sociale;

d) ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike.

4. Zbatimi i detyrimeve të caktuara nga gjykata ndaj të miturit në konflikt me ligjin kërkon sigurimin e një bashkëpunimi efektiv ndërmjet strukturave dhe autoriteteve qendrore e vendore si dhe organizatave që mbrojnë të drejtat e fëmijës.

5. Drejtuesi i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore dhe drejtuesi i njësisë së mbrojtjes së fëmijës pranë organeve të vetëqeverisjes vendore përgatit e përditëson listat e autoriteteve kompetente dhe të personave përgjegjës dhe ia dërgon ato strukturave vendore të Policisë së Shtetit, Prokurorisë dhe seksionit/gjykatës përkatës.

6. Kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së personave përgjegjës janë të njëjta me ato të përfaqësuesve proceduralë, të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.

III. Autoritetet kompetente në nivel vendor

1. Autoritete përgjegjëse, në rastin e vendimit të gjykatës që i mituri në konflikt me ligjin të ndjekë arsimin e detyrueshëm ose, sipas rastit, një program mësimor, janë:

a) drejtuesi i njësisë arsimore vendore, përgjegjës për arsimin parauniversitar;

b) përfaqësuesi i njësisë arsimore vendore, përgjegjës për arsimin parauniversitar, që mbulon institucionin arsimor publik, ofrues të AFP-së (shkollat publike profesionale);

c) mësuesi i klasës apo mësuesi kujdestar.

2. Autoritetet përgjegjëse, në zbatim të vendimit të gjykatës që i mituri në konflikt me ligjin të ndjekë një program të arsimit dhe formimit profesional, sipas ligjit për arsimin profesional, janë:

a) drejtuesit e programeve mësimore të arsimit dhe të formimit profesional (AFP);

b) personeli mësimdhënës i institucionit, ofrues të AFP-së.

3. Autoriteti përgjegjës, në zbatim të vendimit të gjykatës që i mituri në konflikt me ligjin të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, e siguruar nga programet sociale të nxitjes së punësimit, është drejtuesi i zyrës rajonale ose vendore të punësimit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

4. Autoritetet përgjegjëse, në zbatim të vendimit të gjykatës që i mituri në konflikt me ligjin të ndjekë një program rehabilitues të trajtimit psikologjik ose mjekësor, përfshirë, sipas rastit, trajtimin detoksifikues nga përdorimi i alkoolit ose drogës, janë:

a) shërbimet e shëndetit mendor për fëmijët dhe të rinjtë në nivel vendor ose qendror;

b) drejtoritë/institucionet e kujdesit të shëndetit (specialistët e shëndetit, mjekët e spitaleve, mjeku i familjes);

c) strukturat e mbrojtjes së fëmijës në njësinë e vetëqeverisjes vendore;

ç) drejtoritë rajonale të shërbimit social shtetëror;

d) Urdhri i Psikologut.

5. Autoritetet përgjegjëse, në zbatim të vendimit të gjykatës që i mituri në konflikt me ligjin të mos frekuentojë vende të caktuara dhe të shoqërohet me persona të caktuar, janë:

a) shërbimi i provës;

b) strukturat vendore të Policisë së Shtetit;

c) ofruesit publikë e privatë të shërbimeve për fëmijët;

ç) mësuesit;

d) prindërit ose kujdestarët e të miturit.

IV. Bashkëpunimi i autoriteteve kompetente

1. Në rast se përmbushja e detyrimit të caktuar nga gjykata përfshin më shumë se dy autoritete kompetente, plani individual parashikon protokollet e komunikimit ndërmjet tyre dhe të bashkërendimit të veprimtarisë.

2. Autoritetet kompetente bashkëpunojnë me shoqërinë civile dhe organizatat jofitimprurëse, që ofrojnë shërbime në fushën e të drejtave të të miturve.

3. Nëse vendimi i prokurorisë apo gjykatës parashikon detyrimin periodik për raportim, drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore, në bashkëpunim me autoritetin përgjegjës lidhur me detyrimin e caktuar nga gjykata, përcakton në planin individual personin përgjegjës, që mban marrëdhëniet me gjykatën.

4. Në rastin e zbatimit të pikës 3, të këtij kreu, personi përgjegjës përgatit një raport me shkrim

dhe, nëse çmohet e nevojshme nga prokuroria apo gjykata, mund të pyetet për ecurinë e përmbushjes së detyrimit të caktuar dhe marrjen e masave konkrete, rast pas rasti.

5. Raporti, sipas pikës 4, të këtij kreu, mbështetet në të dhënat e marra nga autoritetet e përcaktuara e të përfshira në realizimin e planit individual, në varësi të detyrimit të caktuar me vendim të prokurorisë apo gjykatës.

V. Procedura për zbatimin e vendimit të gjykatës për përmbushjen e një detyrimi të caktuar

1. Procedura për zbatimin e vendimit të gjykatës për përmbushjen e një detyrimi të caktuar përcaktohet në planin individual.

2. Drejtuesi i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në nivel vendor dhe autoritetet përgjegjëse, të caktuara në vendimin e gjykatës, janë kompetente dhe përgjegjëse për miratimin e planit individual për të miturit në konflikt me ligjin, për përmbushjen e detyrimit të caktuar nga gjykata për të miturin në konflikt me ligjin.

3. Drejtuesi i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në nivel vendor dhe autoritetet ose autoriteti kompetent, të caktuara nga gjykata për përmbushjen e detyrimit, në bashkëpunim me grupin teknik ndërsektorial, që funksion në nivel bashkie ose pranë njësisë administrative të bashkisë, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë, nga marrja e këtij vendimi, marrin masa për të lehtësuar e mbështetur zbatimin e planit individual për të miturin konkret, për realizimin e vendimit të gjykatës për përmbushjen e detyrimit/eve të caktuara.

4. Në hartimin e planit individual për të miturin në konflikt me ligjin, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës ndjek parimet, garancitë dhe të drejtat e parashikuara në legjislacionin në fuqi për të drejtat e fëmijëve.

5. Në hartimin e planit individual për të miturin në konflikt me ligjin, për përmbushjen e detyrimit të caktuar, merren në konsideratë:

a) mosha e të miturit;

b) gjendja mendore dhe emocionale;

c) nevojat e veçanta;

ç) mënyra e jetesës dhe nevojat e tij, veçanërisht ato të lidhura me familjen;

d) edukimi ose puna;

dh) motivet e kryerjes së veprës penale;

e) qëndrimi pas kryerjes së veprës penale;

ë) rrethana të tjera, që ndikojnë në vendosjen e detyrimeve, dhe mbikëqyrjen e tyre.

6. Për hartimin e planit individual për të miturin në konflikt me ligjin merret mendimi i të miturit, sigurohet pjesëmarrja e tij, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, si dhe mendimi i prindit të të miturit në konflikt me ligjin.

7. Në hartimin e planit individual për të miturin në konflikt me ligjin mbahet në vëmendje kohëzgjatja e përmbushjes së detyrimit të caktuar në vendimin e gjykatës. Në asnjë rast, kjo kohëzgjatje nuk mund të kalojë kufijtë e caktuar në vendimin gjyqësor.

8. Formati i planit individual për të miturin në konflikt me ligjin miratohet me urdhër të ministrit të Drejtësisë.

VI. Parime mbi trajtimin e të miturit gjatë zbatimit të planit individual

1. Gjatë zbatimit të planit individual për të miturin në konflikt me ligjin, sipas detyrimit të caktuar nga gjykata, i mituri trajtohet me dinjitet nga çdo individ e autoritet dhe informohet për të drejtat e tij dhe mjetet e ushtrimit të tyre.

2. Ndalohet çdo lloj dhune dhe ndëshkimi i të miturit si masë korrigjuese për përmbushjen e detyrimit të caktuar nga gjykata.

3. Të gjitha autoritetet, sipas këtij vendimi, kanë për detyrë të mbrojnë të dhënat personale sipas detyrimeve që përcaktohen në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

4. Autoriteti kompetent dhe personi përgjegjës marrin masa për ruajtjen e konfidencialitetit të të miturit ndaj të tretëve.

5. Të miturit i garantohet ndihma ligjore e psikologjike falas, në përputhje me interesat, zhvillimin dhe aftësitë e fëmijës.

VII. Monitorimi/inspektimi i zbatimit të planit individual për të miturin në konflikt me ligjin

1. Monitorimi/inspektimi i rregullt i punës së autoriteteve, sipas këtij vendimi, kryhet nga strukturat kompetente, sipas natyrës së masës së caktuar.

2. Drejtuesi i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në nivel vendor cakton punonjësin për mbrojtjen e fëmijës si përgjegjës për marrjen e masave për monitorimin e zbatimit

të planit individual dhe të respektimit të të drejtave të të miturit.

3. Vëmendje e veçantë, gjatë monitorimit, i kushtohet përdorimit të forcës, kufizimeve, dënimeve disiplinore dhe formave të tjera të trajtimit të të miturit.

4. Në procesin e monitorimit mund të marrin pjesë edhe organizata që mbulojnë çështjet e drejtësisë për të miturit.

VIII. Njoftimi i planit individual për të miturin në konflikt me ligjin

1. I mituri, prindërit, përfaqësuesit ligjorë të të miturit marrin një kopje të planit individual brenda 24 (njëzet e katër) orëve, nga miratimi i tij.

2. Plani individual për të miturin në konflikt me ligjin përmban pasojat, në rast të moszbatimit të tij, dhe mënyrat e njoftimit të të miturit, prindërve dhe autoriteteve, rast pas rasti.

3. Një kopje e planit individual depozitohet në gjykatë.

IX. Përmbajtja e përgjithshme e planit individual

1. Plani individual për të miturin në konflikt me ligjin përmban, por jo vetëm:

1.1 njësinë e vetëqeverisjes vendore, pranë së cilës i mituri do të përmbushë detyrimin e caktuar nga gjykata, duke u kujdesur që kjo të jetë e njëjtë me vendbanimin e të miturit ose sa më pranë tij;

1.2 aktivitetet konkrete të të miturit për përmbushjen e detyrimit të caktuar nga gjykata;

1.3 të drejtat e të miturit në konflikt me ligjin, me qëllim përmbushjen e detyrimit të caktuar;

1.4 masa të tjera të veçanta, me qëllim përmbushjen e detyrimit të caktuar nga gjykata, të tilla si:

a) këshillim psikologjik;

b) kurse për menaxhimin e zemërimit;

c) trajtim të shëndetit mendor;

ç) mbështetjen e familjes për regjistrimin në gjendje civile;

d) mbështetje për përfshirje në skemën e ndihmës ekonomike;

dh) mbështetje për përfshirje në shërbimet e punësimit;

e) mbështetje për përfshirje në shërbimet shëndetësore;

ë) çdo ndërhyrje tjetër.

1.5 kohëzgjatjen e planit individual, duke caktuar datën e fillimit dhe të mbarimit;

1.6 komunikimin dhe njoftimet gjatë zbatimit të planit individual;

1.7 rregulla lidhur me ndryshimin e planit individual;

1.8 pasojat e moszbatimit ose të shmangies nga zbatimi i planit individual;

1.9 bashkëpunimin institucional dhe ndarjen e përgjegjësive;

1.10 bashkëpunimin me shoqërinë civile;

1.11 të drejtën e ankimit;

1.12 përfundimin e përmbushjes së detyrimit të caktuar.

2. Plani individual për të miturin në konflikt me ligjin, sipas rastit, mund të përmbajë masa për mbështetjen e të miturit në çdo ndërhyrje që do të përmirësonte situatën familjare dhe rolin e familjes, dhe do të garantonte mbrojtjen e fëmijës brenda saj.

3. Plani individual për të miturin në konflikt me ligjin përfshin të dhënat dhe kontaktet e personit përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të tij, si dhe të drejtat e detyrat e tij.

4. Plani individual për të miturin në konflikt me ligjin hartohet në 3 kopje origjinale, të cilat i vihen në dispozicion të miturit/përfaqësuesit ligjor, organit kompetent dhe personit përgjegjës, duke shënuar datën e miratimit dhe të përfundimit të tij.

5. Plani individual për të miturin në konflikt me ligjin nënshkruhet nga i mituri dhe personi përgjegjës.

X. Masa të menjëhershme

1. Në rast se i mituri nuk përmbush detyrimin/et e caktuara nga gjykata në përputhje me planin individual për të miturin në konflikt me ligjin, personi përgjegjës, sipas pikës 3, të kreut IX, të këtij vendimi, njofton menjëherë të miturin, prindin, përfaqësuesin ligjor, me qëllim marrjen e masave konkrete dhe zgjidhjen e rastit.

2. Në rast se i mituri, me gjithë masat e marra sipas pikës 1, të këtij kreu, nuk përmbush detyrimin e caktuar nga gjykata, personi përgjegjës vë në dijeni drejtuesin e zyrës së shërbimeve sociale pranë njësive vendore dhe punonjësin e Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve, të cilët marrin masa të menjëhershme, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Në rast se i mituri nuk zbaton planin individual për të miturin në konflikt me ligjin, autoriteti kompetent, punonjësi i zyrës së shërbimeve sociale pranë njësive të vetëqeverisjes vendore dhe punonjësi i Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve marrin masa për të njoftuar në mënyrë të menjëhershme gjykatën.

XI. Veçoritë e përmbushjes së detyrimit për ndjekjen e arsimit të detyrueshëm ose një program mësimor

1. Autoriteti kompetent, veç parashikimeve të përgjithshme gjatë hartimit e zbatimit të planit individual për të miturin në konflikt me ligjin, mban në vëmendje:

a) nevojat e veçanta/individuale për fëmijën që nuk arrin rezultatet e pritshme, që synon programi mësimor i një klase të caktuar, me qëllim integrimin e tij në sistemin e edukimit;

b) përfshirjen në programet mësimore, që do të ndiqen nga i mituri dhe prindërit, duke i zhvilluar këto në bashkëpunim me të miturin e prindin;

c) masat konkrete për ofrimin e shërbimeve sociale dhe psikologjike brenda mjediseve të shkollës;

ç) masat me qëllim parandalimin e largimit nga shkolla para kohe të fëmijës;

d) masat e tjera, lidhur me ushqimin, pajisjen me libra dhe mjetet didaktike, transportin e të tjera, me qëllim parandalimin e braktisjes së shkollës për arsye ekonomike;

dh) personin përgjegjës që do të mbikëqyrë zbatimin e vendimit të gjykatës brenda mjediseve shkollore dhe, njëherazi, që do të kujdeset për parandalimin, trajtimin brenda shkollës dhe raportimin tek autoritetet përgjegjëse të situatave të dhunës, duke përfshirë edhe ato ndërmjet vetë fëmijës brenda shkollës (*bulizmi*);

e) personin përgjegjës, që do të mbikëqyrë të drejtën e fëmijës për t'u çlodhur, si dhe të drejtën për të marrë pjesë në aktivitete kulturore e artistike;

ë) detyrat e veçanta të mësuesve që japin mësim në këto klasa, lidhur me mbajtjen e dokumentacionit, raportimin e mbarëvajtjes, institucionin/personin ku bëhet raportimi dhe periodicitetin raportimit;

f) rolin e prindërve ose kujdestarëve ligjorë të të miturit.

2. Autoriteti kompetent mund të marrë masa të tjera për përmbushjen e detyrimit të caktuar nga gjykata, duke u bazuar në ligjin për arsimin parauniversitar, legjislacionin për të drejtat e mbrojtjen e fëmijës dhe aktet nënligjore në bazë dhe për zbatimin e tyre.

XII. Veçoritë e përmbushjes së detyrimit për ndjekjen e një programi të formimit profesional, sipas ligjit për arsimin profesional

Autoriteti kompetent, veç parashikimeve të përgjithshme, gjatë hartimit dhe zbatimit të planit individual për të miturin në konflikt me ligjin mban në vëmendje:

a) që programet e formimit profesional të zhvillohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë;

b) pajisen e të miturit me certifikatën përkatëse pas përfundimit të kurseve/ programeve profesionale të ofruara nga këto institucione.

XIII. Veçoritë e përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga marrëdhënia e punës e siguruar nga programet sociale të punësimit

1. Autoriteti kompetent, veç parashikimeve të përgjithshme, gjatë hartimit dhe zbatimit të planit individual për të miturin në konflikt me ligjin, në zbatim të këtij detyrimi, mban në vëmendje se:

a) ndalohet marrja në punë e fëmijës nën moshën 16 vjeç. Përjashtimisht, fëmijët nga mosha 15 deri në 16 vjeç mund të punësohen gjatë pushimeve shkollore vetëm në punë të lehta, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 99, të Kodit të Punës;

b) fëmija mund të kryejë punë të lehta, që nuk dëmtojnë shëndetin, formimin e tij ose e largojnë atë nga shkolla, sipas përcaktimeve të parashikuara në Kodin e Punës;

c) i gjithë dokumentacioni në lidhje me marrëdhëniet e punës plotësohet me ndihmën dhe këshillimin ligjor përkatës.

2. Autoritetet përgjegjëse veprojnë në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës dhe të legjislacionit në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.

XIV. Veçoritë e riparimit të dëmit civil

Autoriteti kompetent, veç parashikimeve të përgjithshme, gjatë hartimit e zbatimit të planit

individual për të miturin në konflikt me ligjin, në zbatim të këtij detyrimi, mban në vëmendje:

a) mundësitë ekonomike të të miturit e të prindërve të tij;

b) mënyrën e reagimit të të miturit pas kryerjes së dëmit dhe marrjen e masave prej tij për të minimizuar pasojat e dëmit;

c) gatishmërinë e të miturit për të kompensuar dëmin me dëmshpërblim në të holla ose në natyrë, nëpërmjet kryerjes së një shërbimi, veprimi, pune ose aktiviteteve të tjera kompensuese;

ç) aftësitë për kryerjen e detyrave të veçanta;

d) mënyrën dhe mjetet e riparimit të dëmit civil.

XV. Veçoritë e përmbushjes së detyrimit për ndjekjen e një programi rehabilitues të trajtimit psikologjik ose mjekësor, përfshirë, sipas rastit, trajtimin detoksifikues nga përdorimi i alkoolit ose drogës

Autoritet përgjegjëse, në ndjekjen e një programi rehabilitues të trajtimit psikologjik ose mjekësor, përfshirë, sipas rastit, trajtimin detoksifikues nga përdorimi i alkoolit ose i drogës, përfshijnë në veprimtarinë e tyre edhe planin individual për të miturin në konflikt me ligjin:

a) përgatitjen e një raporti në lidhje me gjendjen e të miturit në momentin e mbërritjes në institucion, si edhe ecurinë e tij deri në përfundimin e programit rehabilitues;

b) ndjekjen e një programi/plani rehabilitues të trajtimit psikologjik ose mjekësor, përfshirë, sipas rastit, trajtimin detoksifikues nga përdorimi i alkoolit ose drogës, të kombinuar me:

i) këshillim;

ii) punë grupi;

iii) terapi;

iv) kurset me natyrë psikologjike për menaxhimin e inatit, të nervozizmit dhe të gjendjeve të tjera agresive;

v) plan të aktiviteteve kulturore/sportive;

vi) plan të aktiviteteve integruese/ formuese/ argëtuese.

XVI. Veçoritë e përmbushjes së detyrimit për të mos frekuentuar vende të caktuara dhe për të mos u shoqëruar me persona të caktuar, të cilët mund të ndikojnë negativisht në sjelljen dhe edukimin e tij

Autoriteti kompetent, veç parashikimeve të përgjithshme gjatë hartimit dhe zbatimit të planit individual për të miturin në konflikt me ligjin, në përmbushjen e këtij detyrimi mban në vëmendje:

a) që të përfshijë shpjegime dhe këshillim të herëpashershëm të të miturit lidhur me sjellje që ndikojnë negativisht në edukimin e tij;

b) përcaktimin e vendeve që nuk duhet të frekuentohen nga i mituri;

c) një listë të personave me të cilët i mituri nuk duhet të shoqërohet;

ç) bashkëpunimin e ngushtë me familjen, shkollën dhe shoqërinë civile, veçanërisht në mbikëqyrjen nga ana tyre të përdorimit të mjeteve të teknologjisë së informacionit dhe informacionit të transmetuar në rrugë elektronike.

XVII. Dispozita të fundit

Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit, ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit, ministria përgjegjëse për çështjet e shëndetit dhe mbrojtjes sociale për fëmijët, ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 208, datë 10.4.2019

PËR PËRBËRJEN, MËNYRËN E FUNKSIONIMIT, KOMPETENCAT DHE SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 37, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Dispozita të përgjithshme

Ky vendim ka për qëllim të rregullojë përbërjen, mënyrën e funksionimit, ushtrimin e kompetencave dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale.

II. Përbërja dhe organizimi i këshillit

1. Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM) është organ kolegjial vendimmarrës pranë ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

2. KKTKJ-ja përbëhet nga 15 anëtarë: nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, që e kryeson, dhe 14 anëtarë që emërohen prej tij.

3. Anëtarë të KKTKM-së janë:

a) ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore;

b) përfaqësues të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK)3;

c) përfaqësues nga drejtoritë përgjegjëse për çështjet e trashëgimisë kulturore në ministrinë përgjegjëse për kulturën 2;

ç) përfaqësues të Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore (IKRTK)1;

d) jurist i ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore 1;

dh) personalitete të fushës së arkeologjisë 2;

e) përfaqësues nga Universiteti i Tiranës 2;

ë) personalitete të fushës së trashëgimisë kulturore materiale, të cilët kanë një eksperiencë të pasur profesionale ose akademike në disiplinat e arkeologjisë, restaurimit dhe konservimit të pasurive kulturore materiale, trashëgimisë arkitektonike apo menaxhimit të trashëgimisë kulturore materiale 3.

4. Anëtarët e KKTKM-së përmbushin detyrën e përgjegjësitë e tyre dhe deklarojnë çdo rast të konfliktit të mundshëm të interesit, në përputhje me ligjin nr.9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", të ndryshuar.

5. Mandati i anëtarit të KKTKM-së është 2 vjet, me të drejtë riemërimi. Anëtari qëndron në detyrë dhe përmbush funksionet deri në emërimin e anëtarit të ri.

6. Anëtari i KKTKM-së, i parashikuar në shkronjat "b", "c", "ç" dhe "d", të pikës 3, të këtij kreu, propozohet nga titullari përkatës, duke u bazuar në kriteret, si më poshtë:

a) të jetë nëpunës/punonjës i nivelit drejtues të një drejtorie ose sektori;

b) të gëzojë reputacion të lartë profesional;

c) të ketë njohuri për trashëgiminë kulturore materiale;

ç) të ketë jo më pak se 5 (pesë) vjet përvojë pune në institucionet e trashëgimisë kulturore;

d) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre penale;

7. Anëtari i KKTKM-së, i parashikuar në shkronjat "dh", "e" dhe "ë", të pikës 3, të këtij kreu, propozohet nga titullari përkatës, duke u bazuar në kriteret, si më poshtë:

a) të jetë nga radhët e personelit akademik, i punësuar me kohë të plotë ose të pjesshme në institucionet e arsimit të lartë, publik ose privat, të licencuar dhe akreditуar sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë;

b) të kenë përvojë në punë jo më pak se 10 (dhjetë) vjet në fushën e trashëgimisë kulturore materiale;

c) të zotërojnë tituj akademikë.

8. Mandati i anëtarit të KKTKM-së mbaron, kur:

a) përfundon afati 2-vjeçar, nga emërimi;

b) lirohet nga funksioni zyrtar, përveç personaliteteve nga fushat e trashëgimisë kulturore dhe arkeologjisë;

c) jep dorëheqjen.

9. Anëtari i KKTKM-së lirohet nga detyra para mandatit, nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore,:

a) kur nuk paraqitet, pa shkak të justifikuar, në 5 mbledhje të njëpasnjëshme të KKTKM-së;

b) për shkaqe objektive, që e bëjnë të paaftë për të kryer funksionet e ngarkuara;

c) kur nuk përmbush detyrimet si anëtar i KKTKM-së;

ç) kur dënohet me vendim penal të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

d) kur veprimet apo mosveprimet e tij kanë dëmtuar rëndë veprimtarinë dhe emrin e KKTKM-së.

10. Pranë KKTKM-së funksionojnë këto struktura administrative:

a) këshilli teknik;

b) sporteli unik;

c) sekretaria teknike.

11. Këshilli teknik është organ kolegjial seleksionues, vlerësues e vendimmarrës, që ka në përbërje 7 anëtarë, të cilët janë pjesë e 15 anëtarëve të KKTKM-së.

12. Këshilli teknik kryesohet nga drejtori i përgjithshëm i Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK) dhe vepron si trupë shqyrtuese dhe seleksionuese e përputhshmërisë së kërkesave të paraqitura pranë KKTKM-së. Vendimi ose relacioni që i dërgohet KKTKM-së nga ana e Këshillit teknik firmoset nga kryetari.

13. Këshilli teknik ka kompetencë të miratojë kërkesa që lidhen me ndërhyrjet me karakter mirëmbajtje të pasurive kulturore, sipas listës së ndërhyrjeve të miratuara nga KKTKM-ja.

14. Për çështje të tjera, që, sipas parashikimeve të ligjit nr. 27/2018 janë kompetencë e KKTKM-së, këshilli teknik, pasi shqyrton përputhshmërinë e kërkesave të paraqitura, miraton relacionin përkatës, të hartuar nga sekretaria teknike, dhe ia përcjell për vendim Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale.

15. Sporteli unik është pjesë e strukturës administrative pranë IKTK-së, ku depozitohen të gjitha kërkesat për aplikim, për të cilat është kompetente KKTKM-ja. Detyrat, funksionet dhe mënyra e ushtrimit të tyre përcaktohen në rregulloren për veprimtarinë e KKTKM-së.

16. Sekretaria teknike është pjesë e strukturës administrative të IKTK-së, në funksion të KKTKM-së, e cila administron kërkesat dhe përgatit dokumentacionin për vendimmarrje të KKTKM-së. Detyrat, funksionet dhe mënyra e ushtrimit të tyre përcaktohen në rregulloren për veprimtarinë e KKTKM-së.

III. Funksionimi i këshillit

1. KKTKM-ja mblidhet jo më pak se një herë në 2 muaj. Mbledhjet e këshillit thirren nga kryetari dhe njoftimi përcillet nga sekretaria teknike, të paktën, 3 ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen. Në raste të veçanta, mbledhja mbahet edhe në një ditë të ndryshme nga ai i njoftimit, kur janë të pranishëm të gjithë anëtarët dhe miratojnë, paraprakisht, zhvillimin e mbledhjes. Vendimi reflektohet në procesverbalin e mbledhjes.

2. Njoftimi për thirrjen e mbledhjes përmban vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës. Njoftimit i bashkëlidhet edhe relacioni i këshillit teknik si dhe materiale të tjera, lidhur me çështjet e rendit të ditës. Rendi i ditës miratohet nga kryetari.

3. Mbledhja e këshillit mund të kërkohet edhe nga 1/3 e anëtarëve, duke i drejtuar kërkesë ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Zhvillimi i mbledhjes, në këtë rast, miratohet nga kryetari dhe u njoftohet të gjithë anëtarëve.

4. Mbledhjet e KKTKM-së zhvillohen gjithmonë në prani të kryetarit dhe janë të vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij. Në rast të mosarritjes së kuorumit të kërkuar, kryetari thërret mbledhjen pasardhëse.

5. KKTKM-ja vendos me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm, me përjashtim të vendimeve për miratimin e lejes për ndërhyrje, sipas nenit 80, të ligjit nr.27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", për të cilën vendos me shumicë absolute.

6. Vendimet e KKTKM-së merren me votim të hapur. Anëtarët e KKTKM-së, që janë të pranishëm në mbledhje, nuk mund të abstenojnë.

7. Kryetari i KKTKM-së voton i fundit. Në rastet kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, vota e kryetarit është përcaktuese.

8. Vendimet e KKTKM-së nënshkruhen nga kryetari dhe siglohen nga sekretari i KKTKM-së.

IV. Kompetencat e këshillit

1. Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, përfshirë edhe ato të përcaktuara në nenin 38, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", ka këto kompetenca:

a) licencon dhe u revokon licencën subjekteve, personave fizikë apo juridikë në fushën e trashëgimisë kulturore, në projektim, zbatim, mbikëqyrje, kolaudim, vlerësim, veprimtari arkeologjike, të arkeologjisë së shpëtimit dhe arkeologjisë nënujore;

b) miraton projektet e mirëmbajtjes, të ruajtjes dhe restaurimit të pasurive kulturore materiale, të hartuara nga institucionet e trashëgimisë kulturore që mbulojnë veprimtarinë përkatëse, si dhe subjektet e licencuara për këtë qëllim;

c) mbikëqyr veprimtarinë në fushën e pasurive kulturore materiale dhe të pasurive të peizazhit;

ç) miraton lejet për ndërhyrjet me karakter ruajtës e mbrojtës të pasurive kulturore të

paluajtshme, sipas parashikimeve të këtij ligji, si dhe lejet e parashikuara në këtë ligj;

d) miraton, në parim, kërkesën për deklarimin e interesit kulturor;

dh) miraton, në parim, shpalljen e qendrave historike, të parqeve e zonave arkeologjike dhe zonat mbrojtëse të pasurive kulturore;

e) harton akte të karakterit të përgjithshëm, me qëllim sigurimin e uniformitetit të vlerësimit të interesit kulturor;

ë) miraton, vlerëson, në parim, planet e përgjithshme dhe të detajuara vendore, në rastet e përfshirjes në këto plane të zonave të mbrojtura të trashëgimisë kulturore;

f) këshillon ministrin përgjegjës për trashëgiminë kulturore gjatë shqyrtimit prej tij të kërkesave të subjekteve të veçanta për ushtrimin e aktiviteteve tregtare në zona me pasuri kulturore;

g) autorizon institucionet e specializuara dhe/ose subjektet e licencuara për përdorimin e aparaturave metalkërkuese për kryerjen e gërmimeve me karakter arkeologjik;

gj) miraton dhe revokon lejet për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike në territore të njohura ose jo si zona me vlera arkeologjike;

h) miraton planet e zhvillimit, të projekteve restauruese e konservuese dhe projektet kërkimore-shkencore të njësive të administrimit dhe koordinimit të parqeve arkeologjike;

i) miraton hulumtimet arkeologjike sistematike, me karakter kërkimor-shkencor, dhe hulumtimet arkeologjike parandaluese e të shpëtimit;

j) miraton dhe revokon lejet për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike nënujore;

k) vendos për vijueshmërinë e punimeve në rastin e gjetjeve rastësore, sipas neneve 145 e 146, të ligjit nr. 27/2018;

l) këshillon ministrin përgjegjës për trashëgiminë kulturore lidhur me hapjen e procedurës së konkurrimit për dhënien në rijetëzim;

ll) shprehet me vendim për kërkesat për ndryshimin e destinacionit të përdorimit të pasurive kulturore, në përputhje me kompetencat e saj;

m) Shprehet lidhur me marrëveshjet e bashkëpunimit dy ose shumëpalëshe ndërmjet institucioneve vendase dhe të huaja apo subjekteve të licencuara për kryerjen e veprimtarive hulumtuese;

n) miraton projektet e zhvillimeve transformuese në territor, sipas nenit 134, të ligjit nr. 27/2018;

nj) miraton dhënien në përdorim, në formën e rijetëzimit, të pasurive kulturore të regjistruara si pasuri kulturore "me rëndësi kombëtare", sipas nenit 183, të ligjit nr. 27/2018;

o) shprehet me vendim për verifikimin e interesit të veçantë publik të pasurive të peizazhit kulturor;

p) miraton projektet për ndërhyrje në pasuritë e peizazhit kulturor, sipas nenit 251, të ligjit nr. 27/2018;

q) merr vendim për përcaktimin e distancave, të masave/hapësirave dhe varianteve të projektit në fazë ekzekutimi, të nevojshme për të siguruar ruajtjen e vlerave të pasurive të peizazhit kulturor;

r) çdo kompetencë tjetër, të parashikuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e trashëgimisë kulturore.

2. Këshilli teknik shprehet me vendim përfundimtar lidhur me kërkesat për ndërhyrjet me karakter mirëmbajtjeje. Llojet e ndërhyrjeve, sipas kësaj pike, përcaktohen me vendim të KKTKM-së.

3. KKTKM-ja shqyrton kërkesën për deklarimin e interesit kulturor ose për miratim, në parim, të vendimit për shpalljen e qendrave historike, të parqeve dhe zonave arkeologjike, mbi bazën e vendimit të komisionit këshillimor, përkatës, për vlerësimin dhe identifikimin e vlerave kulturore, të ngritur sipas nenit 59, të ligjit nr. 27/2018. Institucioni i specializuar, përkatës, përcjell për miratim, në parim, pranë KKTKM-së vendimin e komisionit dhe dokumentacionin shoqërues.

4. KKTKM-ja miraton dhe vlerëson, në parim, planet e përgjithshme e të detajuara vendore, në rastet e përfshirjes në këto plane të zonave të mbrojtura të trashëgimisë kulturore, si dhe lejet zhvillimore përpara miratimit të tyre nga organet kompetente, në bazë të ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

V. Shpërblimi i anëtarëve të këshillit

Shpërblimi për pjesëmarrje në mbledhje, për çdo anëtar, bëhet sipas përcaktimeve të bëra në vendimin normativ të masës së shpërblimit të

këshillave, bordeve ose komisioneve të njësive të qeverisjes qendrore.

VI. Dispozitat të fundit dhe tranzitore

1. Aplikimet e nisura për shqyrtim dhe vendimmarrje nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve (KKR) dhe Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë (KKA) trajtohen sipas akteve të krijimit të KKR-së dhe KKA-së, deri në ngritjen e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK).

2. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale dhe institucionet e tjera në fushën e trashëgimisë kulturore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 209, datë 10.4.2019

PËR PËRBËRJEN, MËNYRËN E FUNKSIONIMIT, KOMPETENCAT DHE SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË TRASHËGIMISË KULTURORE JOMATERIALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 37, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Dispozita të përgjithshme

Ky vendim ka për qëllim të rregullojë përbërjen, mënyrën e funksionimit, ushtrimin e kompetencave dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale.

II. Përbërja e Këshillit

1. Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Jomateriale (KKTKJ) është organ kolegjial vendimmarrës pranë ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

2. KKTKJ-ja përbëhet nga 11 anëtarë: nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, që e kryeson, dhe 10 anëtarë që emërohen prej tij.

3. Anëtarë të KKTKJ-së, janë:

a) ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore;

b) drejtori i Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Tradicionale (QKVT);

c) përfaqësues nga drejtoritë përgjegjëse për çështjet e trashëgimisë kulturore jomateriale në ministrinë përgjegjëse për kulturën: 2;

ç) përfaqësues i Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore (IKRTK): 1;

d) jurist i ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore:1;

dh) përfaqësues i Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimeve të Artit:1;

e) personalitete të fushës së trashëgimisë kulturore jomateriale, të cilët kanë një eksperiencë të pasur profesionale ose akademike në disiplinat e etnografisë, etnomuzikologjisë, organologjisë, etnokoreologjisë, folklorit apo menaxhimit të trashëgimisë kulturore jomateriale: 4.

4. Anëtarët e KKTKJ-së përmbushin detyrën e përgjegjësitë e tyre dhe deklarojnë çdo rast të konfliktit të mundshëm të interesit, në përputhje me ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", të ndryshuar.

5. Mandati i anëtarit të KKTKJ-së është 2 vjet, me të drejtë riemërimi. Anëtari qëndron në detyrë dhe përmbush funksionet deri në emërimin e anëtarit të ri.

6. Anëtari i KKTKJ-së, i parashikuar në shkronjat "c", "ç" dhe "d", të pikës 3, të këtij kreu, propozohet nga titullari përkatës, duke u bazuar në kriteret, si më poshtë:

a) të jetë nëpunës/punonjës i nivelit drejtues të një drejtorie ose sektori;

b) të gëzojë reputacion të lartë profesional;

c) të ketë njohuri për trashëgiminë kulturore jomateriale;

d) të ketë jo më pak se 5 (pesë) vjet përvojë pune në institucionet e trashëgimisë kulturore;

e) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre penale;

7. Anëtari i KKTKM-së, i parashikuar në shkronjat "dh" dhe "e", të pikës 3, të këtij kreu,

propozohet nga titullari përkatës, duke u bazuar në kriteret, si më poshtë:

a) të jetë nga radhët e personelit akademik, të punësuar me kohë të plotë ose të pjesshme, të institucioneve të arsimit të lartë, publik ose privat, të licencuar e akreditуar sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë;

b) të ketë përvojë në punë jo më pak se 10 (dhjetë) vjet në fushën e trashëgimisë kulturore materiale;

c) të zotërojë titуj akademikë.

8. Mandati i anëtarit të KKTKJ-së mbaron kur:

a) përfundon afati 2-vjeçar, nga emërimi;

b) lirohet nga funksioni zyrtar, përveç personaliteteve nga fusha e trashëgimisë kulturore jomateriale;

c) jep dorëheqjen.

9. Anëtari i KKTKJ-së lirohet nga detyra para mandatit, nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore,:

a) kur nuk merr pjesë, pa arsye, në 2 mbledhje të njëpasnjëshme të KKTKJ-së;

b) për shkaqe objektive, që e bëjnë të paaftë për të kryer funksionet e ngarkuara;

c) kur nuk përmbush detyrimet si anëtar i KKTKJ-së;

ç) kur dënohet me vendim penal të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

d) kur veprimet apo mosveprimet e tij kanë dëmtuar rëndë veprimtarinë dhe emrin e KKTKJ-së.

III. Organizimi dhe funksionimi i këshillit

1. KKTKJ-ja mblidhet jo më pak se një herë në 6 muaj. Mbledhjet e këshillit thirren nga kryetari dhe njoftimi përcillet nga sekretaria teknike, të paktën, 3 ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen. Në raste të veçanta, mbledhja zhvillohet edhe në një ditë të ndryshme nga ai i njoftimit, kur janë të pranishëm të gjithë anëtarët, të cilët miratojnë, paraprakisht, zhvillimin e mbledhjes. Vendimi reflektohet në procesverbalin e mbledhjes.

2. Njoftimi për thirrjen e mbledhjes përmban vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës. Njoftimit i bashkëlidhen edhe materiale të tjera, lidhur me çështjet e rendit të ditës. Rendi i ditës miratohet nga kryetari.

3. Mbledhja e këshillit mund të kërkohet edhe nga 1/3 e anëtareve, duke i drejtuar kërkesë ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Zhvillimi i mbledhjes, në këtë rast, miratohet nga kryetari dhe u njoftohet të gjithë anëtareve.

4. Mbledhja e KKTKJ-së është e vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij. Në rast të mosarritjes së kuorumit të kërkuar, kryetari thërret mbledhjen pasardhëse.

5. KKTKJ-ja vendos me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm.

6. Vendimet e KKTKJ-së merren me votim të hapur.

7. Anëtarët e KKTKJ-së, që janë të pranishëm në mbledhje, nuk mund të abstenojnë.

8. Kryetari i KKTKJ-së voton i fundit. Në rastet kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, vota e kryetarit është përcaktuese.

9. KKTKJ-ja asistohet në veprimtarinë e saj nga sekretaria teknike pranë QKVT-së.

IV. Kompetencat e këshillit

1. Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Jomateriale, përfshirë edhe ato të përcaktuara në nenin 39, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", ka këto kompetenca:

a) mbikëqyr veprimtarinë në fushën e pasurive kulturore jomateriale;

b) miraton, në parim, kërkesën për deklarimin e interesit kulturor;

c) harton dhe miraton strategjinë dhe programe të zhvillimit në fushën e trashëgimisë kulturore jomateriale;

ç) ndjek dhe mbikëqyr veprimtaritë që zhvillohen në fushën e trashëgimisë kulturore jomateriale;

d) propozon programe pune për edukimin nëpërmjet trashëgimisë kulturore jomateriale;

dh) miraton planin vjetor të aktiviteteve kombëtare që zhvillon Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale;

e) propozon projekte dhe masat që duhen ndërmarrë për ruajtjen e mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore jomateriale, sidomos atyre që janë në rrezik;

ë) propozon e miraton programin e katalogimit dhe digjitalizimit të trashëgimisë kulturore jomateriale, që realizohet në Institutin Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore;

f) propozon dhe miraton vlerat e trashëgimisë jomateriale kombëtare për regjistrim në listën përfaqësuese të dukurive jomateriale të UNESCO-s;

g) miraton propozimet e QKVT-së për "Kryevlerat Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale";

gj) shqyrton propozimet e subjekteve të ndryshme për regjistrim në listën përfaqësuese të dukurive jomateriale të UNESCO-s.

2. Me qëllim ushtrimin e kompetencave mbikëqyrëse, KKTKJ-ja mund të kërkojë sqarime për çështje të caktuara ose raportime nga QKVT-ja apo institucione të tjera të specializuara. KKTKJ-ja mund të ngarkojë këto institucione edhe me detyrimin e kryerjes së raportimeve periodike për çështjet që janë kompetencë e këtij organi. Për raste të veçanta, KKTKJ-ja fton si pjesëmarrës të jashtëm në mbledhje edhe specialistë të fushave të ndryshme të trashëgimisë kulturore jomateriale.

3. KKTKJ-ja shqyrton kërkesën për deklarimin e interesit kulturor mbi bazën e vendimit të komisionit këshillimor përkatës për vlerësimin dhe identifikimin e vlerave kulturore, të ngritur sipas nenit 59, të ligjit nr. 27/2018. Institucioni i specializuar përkatës përcjell për miratim, në parim, pranë KKTKJ-së vendimin e komisionit dhe dokumentacionin shoqërues.

V. Shpërblimi i anëtarëve të këshillit

Shpërblimi për pjesëmarrje në mbledhje, për çdo anëtar, bëhet sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e masës së shpërblimit të këshillave, bordeve ose komisioneve të njësive të qeverisjes qendrore.

VI. Dispozitat e fundit

Ngarkohen Ministria e Kulturës, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Jomateriale dhe institucionet e tjera në fushën e trashëgimisë kulturore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 240, datë 4.4.2019

PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR NDARJEN E KOMPENSIMIT FINANCIAR TË OPERATORËVE ME EKSPERIENCË NË TRANSMETIMET NUMERIKE DHE OPERATORËVE PRIVATË HISTORIKË KOMBËTARË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të pikës 4, të nenit 6, të ligjit nr. 34/2017, "Për lirimin e frekuencave të digjital-dividentit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

I. Ndarjen e kompensimit financiar për kategoritë operatorë privatë historikë kombëtarë dhe operatorë me eksperiencë në transmetimet numerike, si më poshtë vijon:

1. Operatorët me eksperiencë në transmetimet numerike të kompensohen në masën 2 000 000 (dy milionë) euro, për mbulimin e pjesshëm të investimeve që dalin jashtë funksionit si rezultat i ndryshimeve teknologjike, sipas ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

2. Operatorët privatë historikë kombëtarë të kompensohen në masën 2 000 000 (dy milionë) euro, për mbulimin e pjesshëm të investimeve të kryera për ndryshimin e infrastrukturës së transmetimit, nga analoge në numerike.

3. Vlera e kompensimit për operatorët me eksperiencë në transmetimet numerike do të llogaritet me përqindjen që vlera financiare për përgjegjësitë tatimore, e paguar prej secilit operator, zë në totalin e vlerës financiare për përgjegjësitë tatimore të paguara nga të gjithë operatorët me eksperiencë në transmetimet numerike.

4. Vlera e kompensimit për operatorët historikë kombëtarë do të ndahet në mënyrë të barabartë.

5. Operatori me eksperiencë në transmetimet numerike, për të përfituar kompensimin financiar sipas pikës 1, të këtij vendimi, duhet të depozitojë pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, si më poshtë vijon:

a) Ekstraktin historik për të dhënat e subjektit, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

b) Relacionin e vlerësimit të firmosur dhe të vulosur nga një ekspert kontabël i autorizuar sipas legjislacionit në fuqi, mbi përgjegjësinë tatimore të paguar pas datës 4 prill 2013 e deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Relacioni duhet të përfshijë informacion për masën e paguar nga subjekti për tatimin mbi vlerën e shtuar, tatimin mbi fitimin, tatimin mbi pagat dhe kontributet për të punësuarit, taksat kombëtare, tarifat sipas llojit të ushtrimit të aktivitetit, tatimin e mbajtur në burim ku deklarohen (dividenti, tatimi mbi qiradhënie, shërbimet teknike etj.), taksat lokale e akcizën, dhe duhet të depozitohet në AMA, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga njoftimi i këtij të fundit. Në të kundërt, vlerësimi i masës së përgjegjësive tatimore të paguara prej subjekteve përfituese do të përcaktohet nga AMA, bazuar në të dhënat e pasqyrave financiare vjetore të depozituara pranë AMA-s.

c) Vërtetim lëshuar prej organeve tatimore, që konfirmon shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

ç) Vërtetim lëshuar prej organeve përkatëse, që konfirmon shlyerjen e detyrimeve sipas ligjit për taksat kombëtare, për të cilat operatori është subjekt.

6. Operatori privat historik kombëtar, për të përfituar kompensimin financiar, duhet të depozitojë pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, si më poshtë vijon:

a) Ekstraktin historik për të dhënat e subjektit, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

b) Dokumentacionin financiar për investimet e kryera për ndryshimin e infrastrukturës së transmetimit, nga analoge në numerike (përshtatjen e pajisjeve ekzistuese, instalimin e pajisjeve të reja të sistemit të transmetimit) etj., si fatura tatimore blerjeje, fatura zhdoganimi, kontrata shërbimi.

c) Vërtetimin e lëshuar nga organet tatimore, që konfirmon shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

ç) Vërtetimin e lëshuar nga organet përkatëse, që konfirmon shlyerjen e detyrimeve sipas ligjit për taksat kombëtare, për të cilat operatori është subjekt.

7. Autoriteti i Mediave Audiovizive shqyrton dokumentacionin e subjekteve dhe kryen veprimet, si më poshtë vijon:

a) Verifikon nëse subjektet kanë detyrime financiare të pashlyera ndaj saj.

b) Verifikon nëse subjektet kanë detyrime financiare për sanksione gjobë të shndërruara në titull ekzekutiv.

c) Verifikon nëse subjektet përdorin frekuenca pa autorizimin/licencimin e Autoritetit të Mediave Audiovizive.

8. Autoriteti i Mediave Audiovizive kryen pagesën për operatorët me eksperiencë në transmetimet numerike dhe operatorët historikë kombëtarë pas plotësimit të kërkesave sipas këtij vendimi.

II. Ngarkohet Autoriteti i Mediave Audiovizive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

UDHËZIM
Nr. 3, datë 3.4.2019

PËR INFORMIMIN E MINISTRISË SË MBROJTJES NGA STRUKTURAT DHE SHA-të NË VARTËSI TË SAJ MBI ZHVILLIMIN E ANKANDEVE DHE LIDHJEN E KONTRATAVE NË ZBATIM TË PROCEDURAVE TË ANKANDEVE, PROKURIMEVE DHE MARRËVESHJEVE TË TJERA

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të ndryshuar, si dhe germës "f", të pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2014 "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

KREU I
QËLLIMI, FUSHA E ZBATIMIT DHE PËRKUFIZIMET

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është informimi dhe monitorimi i aktivitetit të kryer nga strukturat dhe sh.a.-të në vartësi të Ministrisë së

Mbrojtjes, në lidhje me aktivitetin e tyre ekonomik.

2. Informacioni në lidhje me aktivitetet e përmendura më sipër do të dërgohet pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Raportim periodik, në zbatim të këtij udhëzimi, do të jetë një përmbledhje e të gjitha aktiviteteve të zhvilluara nga strukturat dhe sh.a.-të, i cili do të paraqitet para Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes në intervale 3-mujore.

4. Udhëzimi do të zbatohet për procedurat e ankandeve, si dhe mbi procedurat e lidhjes së kontratave në zbatim të procedurave të ankandeve, prokurimeve dhe marrëveshjeve të tjera.

5. Udhëzimi do të zbatohet në mënyrë harmonike me detyrimet dhe procedurat e përcaktuara nga ligjet dhe aktet nënligjore të detyrueshme për organet dhe strukturat të cilat janë subjekt i këtij udhëzimi.

KREU II
INFORMACIONI PARAPRAK PËR SECILËN PROCEDURË

1. Përpara zhvillimit të ankandeve dhe lidhjes së kontratave, në zbatim të ankandeve, prokurimeve apo marrëveshjeve të tjera, strukturat e vartësisë dhe sh.a.-të, duhet të përgatisin një informacion të detajuar drejtuar sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes.

2. Informacioni i përmendur në pikën 1 të këtij kreu, duhet të përmbajë:

a) llojin e procedurës që do të zhvillohet;

b) subjektin me të cilin do të lidhet kontrata;

c) ditën dhe mënyrën e zhvillimit të ankandit/prokurimit;

ç) mallrat dhe shërbimet që do të ofrohen nga secila palë.

3. Informacioni i mësipërm duhet të dërgohet minimalisht 3 ditë para zhvillimit të procedurës.

KREU III
RAPORTIMI PERIODIK

1. Strukturat dhe sh.a.-të në vartësi të Ministrisë së Mbrojtjes, në përfundim të çdo tremujori, duhet të përgatisin një raportim periodik për të gjithë procedurat e ankandeve, prokurimeve, si dhe kontratave të lidhura në zbatim të tyre dhe në zbatim të marrëveshjeve të tjera.

2. Ky raportim periodik i dërgohet sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes, brenda datës 5 të muajit pasardhës të periudhës tremujore.

3. Raportimi periodik nënshkruhet nga titullari i strukturës ose sh.a.-së.

KREU IV
DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ngarkohen me zbatimin e këtij udhëzimi sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes dhe të gjithë strukturat dhe sh.a.-të në vartësi të Ministrisë së Mbrojtjes.

2. Moszbatimi i detyrave, sipas këtij udhëzimi, përbën shkak për nisjen e procedurave disiplinore, sipas legjislacionit në fuqi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I MBROJTJES
Olta Xhaçka

UDHËZIM
Nr. 6, datë 2.4.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 9.1.2019, "PËR ZHVILLIMIN E PROVIMEVE KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË, VITI SHKOLLOR 2018-2019"

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të neneve 26 dhe 50, të ligjit nr. 69/2012 datë 21.6.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të vendimit nr. 1013, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve", të ndryshuar dhe vendimit nr. 98, datë 27.2.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)",

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 1, datë 9.1.2019, "Për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë, viti shkollor 2018-2019", shkronja "a" e pikës 1, ndryshon si më poshtë:

"a. Lënda gjuhë e huaj, më 13 qershor 2019.".

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, institucioni përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Besa Shahini

URDHËR
Nr. 128, datë 11.4.2019

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.12.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave" dhe të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, zëvendësministrit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, z. Elton Haxhi.

2. Kompetencat e titullarit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, deleguar sipas pikës 1 (një) të këtij urdhri, do të ushtrohen nga data 11.4.2019 deri më 15.4.2019.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, z. Elton Haxhi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

VENDIM
(i shkurtuar)
Nr. 6660, datë 5.4.2019

NË EMËR TË REPUBLIKËS
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga:
Gjyqtar: ENEIDA CIVICI

asistuar nga sekretare gjyqësore **Anjeza Nergjoni**, sot më datë **5.4.2019**, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike çështjen civile-tregtare me **nr. 6660 Regj. Themeltar**, që i përket:

KËRKUES: "ITSGA" sh.a. e regjistruar në regjistrin tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit, me numër NIUS K51313001H, me seli në adresën: "Rruga e Dibrës", pallat i ri 5-katësh, kati i dytë, përbri Medresesë, ngjitur me Klinikën Ortodokse, Tiranë, Shqipëri.

OBJEKTI: Fillimin e procedurës së falimentit për pasuritë e shoqërisë "ITSGA" sh.a. për shkak të paaftësisë paguese.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 110/2016, datë. 27.10.2016, "Për falimentimin", i ndryshuar.

Gjykata, bazuar në nenet 126, 306-308 të Kodit të Procedurës Civile, nenin 29 e vijues të ligjit 110/2016, "Për falimentimin",

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës së kërkuesit, shoqëria "ITSGA" sh.a.

2. Hapjen, më datë 5.4.2019, të procedurës së falimentimit të shoqërisë "ITSGA" sh.a. me administrator z. Mateos Zoto, me veprimtari "organizim lojërash fati", me NIUS K51313001H dhe me seli në adresën "Rruga e Dibrës", pallat i ri 5-katësh, kati i dytë, përbri

Medresesë, ngjitur me Klinikën Ortodokse, Tiranë, Shqipëri.

3. Caktimin si administratore të falimentimit për shoqërinë "ITSGA" sh.a., të znj. Shpresa Breçani, e datëlindjes 20.3.1964, me nr. personal G45320378H, e licencuar nga Ministria e Drejtësisë me licencën nr. 09, datë 16.10.2012, me NIPT K71529023K, me adresë: Rruga "Panorama" (ish-rruga "Jordan Misja"), pall. Sara-El, kati i dytë, pranë Hipotekës, Tiranë, dhe me cel: 0682094103.

4. Të gjithë kreditorët e shoqërisë "ITSGA" sh.a., të paraqesin pretendimet e tyre tek administratori i falimentimit brenda 45 ditëve nga publikimi i këtij vendimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

5. Çdo person fizik apo juridik, i cili ka detyrime ndaj debitorit shoqëria "ITSGA" sh.a., t'ia paguajnë dhe shlyejnë ato administratorit të falimentit.

6. Caktimin e një komiteti të përkohshëm të kreditorëve, në përputhje me nenin 29, pika "dh", të ligjit nr. 110/2016, "Për falimentimin", duke u caktuar si anëtarë të këtij komiteti Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, si kreditor të pasiguruar dhe si kreditor i preferuar punonjësi ndaj të cilit kërkuesi ka detyrimin më të lartë.

7. Mbledhja e raportimit do të mbahet në datë 20.6.2019, ora 10:00.

8. Urdhërohet botimi i një kopjeje të shkurtuar të këtij vendimi për hapjen e procedurave të falimentimit të subjektit shoqëria "ITSGA" sh.a., në faqen elektronike të Gjykatës, në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe në Fletoren Zyrtare.

9. Ky vendim i njoftohet debitorit shoqëria "ITSGA" sh.a., administratores së falimentit znj. Shpresa Breçani.

10. Administratori i falimentit i komunikon një kopje të këtij vendimi të gjithë kreditorëve të njohur të shoqërisë "ITSGA" sh.a.

11. Administratori i falimentit është i detyruar të bëjë regjistrimin e vendimit sipas nenit 32 të ligjit nr. 110/2016, "Për falimentimin" në të gjitha regjistrat publikë ose institucione të tjera financiare ku janë të regjistruara pasuri ose të drejta të tjera të debitorit.

12. Administratori i falimentit do të shpërblehet sipas VKM-së nr. 197, datë 13.4.2007, "Për kushtet dhe kriteret e përcaktimit të masës së shpërblimit dhe rimbursimit të shpenzimeve të administratorit të falimentit".

13. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen kërkuesit.

14. Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 15 ditëve, afat ky që fillon nga e nesërmja e komunikimit të tij.

U shpall, sot më datë 5.4.2019

GJYQTARE
Eneida Civici

SEKRETARE
Anjeza Nergjoni

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 196 lekë